

# **SHMANGIA NGA TATIMI: FAKTORËT NDIKUES**

Qendra për Arsim, KIPRED

Përgatitur nga: **Blerim Murtezi**

Hulumtimi u përkrahë nga: **Nezir Kraki**

Të drejtat autoriale © 2014 i ka KIPRED. Çdo të drejtë e mban autori. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të ribotohet a të ruhet diku me qëllim rishfrytëzimi, të emetohet në kurrfarë forme apo me kurrfarë mjeti elektronik, mekanik, fotokopjues, inçizues apo tjetër, pa u dhënë paraprakisht leja me shkrim nga botuesi. Ju lusim që për informata të kontaktoni në [info@kipred.org](mailto:info@kipred.org) ose +381 38 227 778.

Publikuar nga:



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave  
Rr. Rexhep Mala, Nr. 5A  
10 000 Prishtinë, Kosovë  
Telefoni dhe Faksi: +381 38 227 778  
[www.kipred.org](http://www.kipred.org)

# SHMANGIA NGA TATIMI NË KOSOVË; FAKTORËT NDIKUES

## HYRJE

Tatimet janë burimi kryesor i mbledhjes së të hyrave publike me të cilat shteti i plotëson të dalat publike, e që janë në kompetencë të tij, pa marrë parasysh se a janë shtete kapitaliste apo socialiste, shtete të zhvilluara apo shtete në zhvillim.<sup>1</sup> Procesi i tranzicionit ngërthen në vete shumë çështje, ndër to edhe sistemim e tatimit, strukturën e administrimit të taksave, shkallën e pjesëmarrjes politike e të tjerë.<sup>2</sup> Shpesh është argumentuar se shmangia nga pagesa e tatimit (Evazioni Fiskal) është një dukuri që shfaqet në vendet në tranzicion.<sup>3</sup> Në nenin 119, paragrafi i tetë i Kushtetutës së Republikës së Kosovës thuhet: "Secili person është i obliguar të paguajë tatimet dhe kontributet tjera të parapara me ligj".<sup>4</sup> Mirëpo, rezultatet e studimit tregojnë se në Kosovë përqindja e evazionit fiskal arrin 39 % duke dëmtuar kështu portfolion/ mundësinë financiare publike, zgjerimin e tregut dhe kontratën kolektive.<sup>5</sup> Me qenë se ka faktor të shumtë të cilët mund të kenë ndikim mbi shmangien nga tatimi, për të qenë racional me lexuesin, ky artikull tenton të argumentojë se dobësitë institucionale,<sup>6</sup> besimi në institucione publike.<sup>7</sup> ekonomia joformale<sup>8</sup> si dhe mos-integrimi socio-ekonomik i komuniteteve<sup>9</sup> janë disa nga faktorët kyç. Pas argumenteve të këtij artikulli jepen rekomandime se çfarë duhet të bëhet për të evituar dukurinë e shmangies nga tatimi.

## DOBËSITË INSTITUCIONALE

---

<sup>1</sup> Sanahoudin Komoni; Financat. Prishtinë: Enti i Statistikave dhe mjeteve mesimore i krahinës socialiste autoktone të Kosovës, 1986. f.340

<sup>2</sup>Benno Torgler . Tax Morale in Transition Countries. (Morali Tatimor në vendet në Tranzicion). Vol. 15. Basel, Switzerland: EBSCO Publishing, 2003.

<sup>3</sup>Martinez-Vazques, J. & McNab, R.M. "The Tax Reform Experiment in Transition Countries (Eksperimenti në reforma tatimore në vendet në tranzicion).," National Tax Journal Vol. 53 (2000): f.27

<sup>4</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 118, Paragrafi 8, f.87

<sup>5</sup> Kosovo Human Development Report. (Raporti i zhvillimit njerëzor në Kosovë) Private sector and employment Prishtinë: UNDP, 2012, f.53

<sup>6</sup> Torgler, Tax morale in Transition Countries, f.359

<sup>7</sup> Benno Torgler, Schneider, Friedrich G. What shapes attitudes toward paying taxes? (Çfarë formëson qëndrimet mbi pagesën e taksave? Bonn: Institute for the study of Labor "IZA", 2006. f.8

<sup>8</sup> Ekonomia informale dhe tranzicioni drejt ekonomisë së tregut." Rugët e reduktimit të ekonomisë informale dhe përfitimet e komunitetit të biznesit. Prishtinë: Aleanca Kosovare e Bizneseve. n.d.: f.8

<sup>9</sup> Alban Zogaj, Fisnik Reçica, Dita Jaka, Alban Hashani, Lumir Abdixhiku, Diellza Gashi, Etida Zeka. Përmirsimi i përfshirjes së kumunitetit serb të Kosovës në aktivitetet ekonomike të Kosovës. Prishtinë: RIINVEST INSTITUTE, 2012. f.23

Dobësitë institucionale ndikojnë në shmangien e tatimit nga ana e qytetarëve dhe bizneseve.<sup>10</sup> Dobësitë institucionale, ndër të tjera nënkuptojnë mungesën e kontrollit institucional dhe mos ndëshkimin e atyre që i shmangen tatimit; mungesën e rrogave adekuate për tatim mbledhësit për të tërhequr dhe mbajtur personel cilësor; mungesën e manualeve dhe teknikave për auditim efektiv të ndërmarrjeve private.<sup>11</sup> Kosova përballet me shumë dobësi institucionale. Mesatarisht, biznesi është i inspektuar për katër ditë në tërë vitin nga administrata tatimore, dy ditë nga doganat dhe afërsisht pesë ditë nga zyrtarët komunalë.<sup>12</sup> Kosova ka numrin më të ulët të inspektorëve tatimorë në 1.000 banorë në rajon ndërsa vetëm 350 inspektorë punojnë në terren. Gjithashtu, Kosova ka hyrë në një proces të kushtueshëm dhe të ndërlikuar të fiskalizimit, me synimin që të pajisë secilin biznes me aparate për regjistrimin e parave. Kjo gjë është kundërshtuar mjaft nga pronarët e bizneseve dhe ende është bërë më pak se një e katërta e rrugës përgjatë fazës së gjatë të implementimit.<sup>13</sup> Zbatimi i dobët institucional ka bërë që pronarët e bizneseve të potencojnë se ndihen të “vetmuar” në menaxhimin e mosmarrëveshjeve mbi obligimet kontraktuale, pasi që autoritetet administrative të Kosovës janë joefikase, të ngadalta dhe të pasigurta.<sup>14</sup> Rjedhimisht, kapacitetet e kufizuara brenda administratës tatimore mundësojnë shmangjen nga tatimi.

## **BESIMI NË INSTITUCIONET PUBLIKE**

Së fundmi ekonomistët kanë filluar t’u kushtojnë vëmendje faktorëve të shmangies nga tatimi siç është besimi në shtet.<sup>15</sup> Ky besim ndërlidhet me besimin në qeveri, parlament dhe besimin në sistemin legal të tatimit.<sup>16</sup> Në mënyrë që të ndërtohet besimi, institucionet shtetore duhet të jenë funksionale dhe popullata duhet ta ndjejë se institucionet janë duke punuar për interesin e popullatës.<sup>17</sup> Veprimet nga shteti në të mirë të qytetarëve, janë të destinuara të rrisin qëndrimet pro pagesës së tatimeve<sup>18</sup> Kështu, nëse ekziston besimi ndaj qeverisë nga ana e qytetarëve dhe

---

<sup>10</sup> Torgler, Tax morale in Transition Countries, f.358-359

<sup>11</sup> Goerge Martinez Vazquez, Robert McNab. Tax system in transition economies (Sistemi i taksave në vendet tranzicion), Atalanta G.A: School of policy studies, Georgia State University, 1997. f.30

<sup>12</sup> Kosovo Human Development Report 2012. f.57.

<sup>13</sup> Po aty., f.56.

<sup>14</sup> Po aty., f.57.

<sup>15</sup> Torgler, Tax morale in Transition Countries, f.363

<sup>16</sup> Benno, Schneider, Friedrich G, What shapes attitudes toward paying taxes? f.8

<sup>17</sup> "Ekonomia informale dhe tranzicioni drejt ekonomisë së tregut." f.26.

<sup>18</sup> Smith, Kent W. Reciprocity and Fairness: Positive Incentives for Tax Compliance (Reciprociteti dhe Drejtësia: stimulimet pozitive për përshtatjen e taksave. Ann Arbor: University of Michigan Press., 1992: f.223-258.

bizneseve, mundësia që tatimpaguesit t'i shmangen tatimit është më vogël sesa kur nuk ekziston ky besim.<sup>19</sup> Si rezultat i zbatimit të dobët të politikave kundër korrupsionit dhe evazionit fiskal, Kosova është duke përjetuar mirëbesim relativisht të ulët në institucionet publike.<sup>20</sup> Për më shumë, nënperformanca dhe evazoni janë bërë norma të biznesit, të kryesuara nga qeveria.<sup>21</sup> Fatkeqësisht, shumica e qytetarëve në Kosovë nuk kanë besim në Kuvendin e Kosovës, Qeverinë dhe në Gjyqësorin.<sup>22</sup> Gjithashtu, qytetarët e Kosovës besojnë se vetë kuvendi është i mbushur me plotë individë që i shmangen tatimit.<sup>23</sup> Pa dyshim që mirëbesimi i ulët i qytetarëve kundrejt institucioneve publike në Kosovë, ndikon që ata të jenë më të prirur për t'i shmangur pagesat tatimore.

## **EKONOMIA JOFORMALE**

Në këtë artikull me “ekonomi joformale” kuptohet një bashkësi e veprimtarive ekonomike të paregjistruara, të cilat karakterizohen nga mospagimi i tatimit dhe detyrimeve për sigurimet shoqërore, ose nga përpjekjet për t'i shmangur përputhjet me disa standarde ligjore dhe administrative.<sup>24</sup> Është e rëndësishme të theksohet se në rastin e punës me pagë joformale, nuk janë vetëm punëtorët, por edhe punëdhënësit e tyre që shmangin regjistrimet dhe tatimin.<sup>25</sup> Në Kosovë përmasat në rritje të ekonomisë joformale janë një shqetësim i madh.<sup>26</sup> Të dhënat nga studimi ofrojnë shifra të ngjashme për joformalitetin e punës me ato për evazionin fiskal. Për shembull rreth 30-40% e punës në Kosovë është joformale.<sup>27</sup> Këto shifra janë shqetësuese ngase përdorimi i kontratave joformale të punës dhe evazoni sistematik i kontributeve të sigurimeve sociale, dobëson mbrojtjen e punonjësve dhe zvogëlon përfitimet e tyre sociale duke çrregulluar kështu qasjet e përgjithshme në shoqëri dhe shpie në prirjen për shmangie nga tatimet.<sup>28</sup>

<sup>19</sup> Torgler, Schneider, Friedrich G, What shapes attitudes toward paying taxes? f. 9

<sup>20</sup> Kosovo Human Development Report, Private sector and employment, f.58

<sup>21</sup> Po aty, f.110

<sup>22</sup> Barometri Kosovar për Siguri. Zërat e Kosovës: Vështrimet dhe Përceptimet. Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2013. f.15

<sup>23</sup> Shmangësit e Pushtetshëm të Tatimit. Marrë nga: <http://gazetajnk.com/?cid=1,3,585> [Qasur me: 5 Gusht 2013]

<sup>24</sup> Ekonomia informale dhe tranzicioni drejt ekonomisë së tregut, f.13.

<sup>25</sup> Martha Alter Chen. Rethinking the Informal Economy (Përbrenda Ekonomisë Informale): Linkages with the Formal Economy and the Formal Regulatory Environment. New York, USA . 2007. f.4

<sup>26</sup> International Labour Office. Porfili i sistemit të sigurisë sociale në Kosovë. Budapest: ILO Sub Regional Office, 2010. f.12

<sup>27</sup> Kosovo Human Development Report, Private sector and employment, f.56.

<sup>28</sup> Ekonomia informale në Republikën e Kosovës. Marrë nga <http://www.mesazhi.com/artikuj/ekonomia-informale-ne-republiken-e-kosoves> [Qasur me: 3 Gusht, 2013, 10:00]

## **INTEGRIMI SOCIO-EKONOMIK I KOMUNITETEVE**

Mbulimi jo i plotë i pikave kufitare, hyrëse, si dhe mos inkuadrimi i komuniteteve pakicë në sistemin tatimor, ka ndikuar në mospagimin e obligimeve tatimore. Rreth 65% e bizneseve në veri të Kosovës janë të regjistruara në Regjistrin e Biznesit të Serbisë, 32% në të dy regjistrat, dhe vetëm 2% në Regjistrin e Biznesit të Kosovës.<sup>29</sup> Nga bizneset e serbëve në Kosovë, 60% paguajnë tatimin në Administratën Tatimore të Kosovës, ndërsa 40% nuk paguajnë fare tatim. Nga ata që nuk e paguajnë tatimin, rreth 60% pohojnë se nuk paguajnë pasi që nuk janë të regjistruar si biznese formale, kurse, pjesa tjetër, mospagimin e tatimit e ndërlidhin me mungesën e një zyre të administratës tatimore për t'i marrë formularët dhe për t'i bërë pagesat.<sup>30</sup>

## **PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME**

Dështimi për t'i paguar tatimet redukton kapacitetin e Qeverisë së Kosovës për t'i shpërndarë të hyrat në mënyrë efektive dhe për të bërë investime. Kjo gjë krijon përparësi të padrejtë për kompanitë jostabile si dhe krijon stimuj për veprime të jashtëligjshme. Gjithashtu, ndikon në marrëdhëniet ndërmjet sektorit privat, qeverisë dhe shoqërisë. Andaj, për të ulur numrin e atyre që nuk paguajnë tatim duhet të ndërmerren këto hapa: të shtohet numri i kapaciteteve për zbatim të përgjegjshëm dhe zbatim të ligjeve duke dyfishuar kapacitetin e administratës tatimore dhe zyrtarëve doganorë; të evidentohen dhe përfshihen në skemën e tatim-taksave bizneset që deri më tani nuk i nënshtrohen detyrimit fiskal; të ngrihet besimi i komunitetit serb për institucionet publike duke ofruar shërbime efektive publike, si dhe të trajtohen bizneset serbe në veri të Kosovës njëjtë me bizneset tjera në vend. Në këtë mënyrë, qytetarët dhe bizneset do ta rrisin besimin në instiucionet publike dhe do ndjehen më të sigurtë kur bëhet fjalë për pagesen e tatimit, gjë që do të ndikojë në uljen e evazionit fiskal.

## **Lista e Referencave**

---

<sup>29</sup> Zogaj, et al, Përmirsimi i përfshirjes së kumunitetit serb të Kosovës në aktivitetet ekonomike të Kosovës, f.

23

<sup>30</sup> Po aty., f.24

- Alban Zogaj, Fisnik Reçica, Dita Jaka, Alban Hashani, Lumir Abdixhiku, Diellza Gashi, Etida Zeka.  
*Përmirsimi i përfshirjes së kumunitetit serb të Kosovës në aktivitetet ekonomike të Kosovës.*  
Prishtinë: RIINVEST INSTITUTE, 2012.
- Barometri Kosovar për Siguri. "Zërat e Kosovës: Vështrimet dhe Përceptimet." Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2013
- Benno Torgler. *Tax Morale in Transition Countries. (Moralit Tatimor në vendet në Tranizcion).* Vol. 15.  
Basel, Switzerland: EBSCO Publishing, 2003.
- Benno Torgler, Schneider, Friedrich G. *What shapes attitudes toward paying taxes? (Cfarë formëson qëndrimet mbi pagesën e taksave?)* Bonn: Institute for the study of Labor "IZA", 2006.
- Martha Alter Chen. "Rethinking the Informal Economy (Përbrenda Ekonomisë Informale)." *Linkages with the Formal Economy and the Formal Regulatory Environment*, 2007: 4.
- Ekonomia informale dhe tranzicioni drejt ekonomisë së tregut.* Prishtinë: Aleanca Kosovare e Bizneseve, n.d.
- Joerge Martinez Vazquez, Robert McNab. *Tax system in transition economies (Sistemi i taksave në vendet tranzicion).* Atalanta G.A: School of policy studies, Georgia State University, 1997.
- Sabahoudin Komoni. *Financat.* Prishtinë: Enti i Statistikave dhe mjeteve mesimore i krahinës socialiste autoktone të Kosovës. 1986.
- Ekonomia informale në Republikën e Kosovës. *Mesazhi.com.* Tetor 17, 2012.  
<http://www.mesazhi.com/artikuj/ekonomia-informale-ne-republiken-e-kosoves> (accessed Gusht 2, 2013).
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës. *Neni 119, Parimet e Pergjithshme, Paragrafi 8.* Prishtinë, 2008.
- Martinez-Vazques, J. & McNab, R.M. *The Tax Reform Experiment in Transition Countries (Eksperimenti me reforma tatimore në vendet në tranzicion).* Vol. 53. National Tax Journal, 2000.
- International Labour Office. *Porfili i sistemit të sigurisë sociale në Kosovë.* Budapest: ILO Sub Regional Office , 2010.
- Kosovo Human Development Report. *Private sector and employment.(Sektori privat dhe punësimi)*  
Prishtinë: UNDP, 2012.
- Smith, Kent W. *Reciprocity and Fairness: Positive Incentives for Tax Compliance (Reciprociteti dhe Drejtësia: stimulimet pozitive për përshtatjen e taksave.* Ann Arbor: University of Michigan Press., 1992.